


Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë

Nr. 1, Tremujori IV/2012



| Indikatorë të zgjedhur | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|--------------------------------|--------|--------|--------|--------|---------|
| Rritja Reale e PBB (%) | 7.2 | 3.5 | 3.2 | 4.5 | 3.8 (f) |
| PBB (mln EUR) | 3710.7 | 4077 | 4136.5 | 4486 | |
| Inflacioni (mesatarja vjetore) | 9.4 | -2.4 | 3.5 | 7.3 | 2.5 |
| Kreditë (mln EUR) | 1183.4 | 1289 | 1458.7 | 1698.1 | 1763.4 |
| Depozitat (mln EUR) | 1444.1 | 1744.8 | 1936.9 | 2104 | 2279 |
| Eksportet (mln EUR) | 198.5 | 165.3 | 294 | 312.5 | 269.3* |
| Importet (mln EUR) | 1928.2 | 1935.5 | 2144.9 | 2479 | 2489* |

*Të dhënat e pakompletuara; (f) Parashikim; Burimi: BQK, ASK dhe FMN (2013)

Përmbledhje

Ekonomia e Kosovës në vitin 2012 shënoi rritje, por norma e rritjes ishte më e ulët krahasuar me vitet paraprake. Ngadalësimi i rritjes si burim kryesor kishte zhvillimet e përgjithshme ekonomike globale. Kjo pasi që investimet e huaja direkte dhe eksportet shënuan rënie të theksuar gjatë vitit 2012, ndërsa importet gjithashtu u karakterizuan me ngadalësim të rritjes. Sidoqoftë, rritja e investimeve publike dhe rritja e dërgesave të emigrantëve kishin kontribut pozitiv në aktivitetin ekonomik. Në anën tjetër, rritja e subvencioneve ndaj sektorit të bujqësisë, të cilat ndihmuan këtë sektor në përshpejtimin e ritmit të zhvillimit, ndikuan që ekonomia e Kosovës të vazhdojë të zgjerohet edhe gjatë vitit 2012.

Zhvillimet në nivelin e çmimeve u karakterizuar me normë të ulët inflacioni. Tregu i bonove të thesarit i cili filloi të funksionojë gjatë vitit 2012 u karakterizua me normë të ulët të interesit si dhe ofertim të lartë nga bankat që reflektojnë se ekonomia e Kosovës ka pozicion të favorshëm fiskal, por me mungesë të kapaciteteve absorbuese për investimet në sektorin real. Ndërmjetësimi financiar nga sistemi bankar vazhdoi trendin e ngadalsuar të rritjes reflektuar përmes kredive. Ngadalsimi i kreditimit reflekton rënien e kërkesës dhe aktivitetit më të ngadalshëm ekonomik.

Ngjarjet kryesore të tremujorit IV

U aprovua licenca për bankën e re me kapital turk “Turkie Is Bankasi A.S”, duke rritur numrin e gjithsej bankave në Kosovë në nëntë.

Struktura e ndërmarrjeve të reja ka ndryshuar në favor të sektorëve që konsiderohen me kapacitete më të mëdha për të krijuar vlerë të shtuar në ekonomi.

Norma e interesit në bono të thesari arriti pikën më të ulët në 14 rundet e zhvilluara.

Parashikimet janë se viti i ardhshëm do të ketë zhvillime më pozitive në krahasim me vitin 2012. Këto zhvillime pritet të nxiten kryesisht nga rritja e asetëve të sistemit bankar si rezultat i hyrjes në treg të një banke të re gjë që do ta rrisë edhe konkurrencën. Përveç sistemit bankar, pritet janë se investimet private pritet të rimarrin veten në krahasim me vitet e fundit.

BOTUES: ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Departamenti i Stabiliteti Financiar dhe Analizave Ekonomike.

Adresa: 33 Garibaldi, Prishtinë 10000, Tel: ++381 38 222 055, Fax: ++381 38 243 763; Adresa Elektronike: economicanalysis@bqk-kos.org;

Kryeredaktor: Gani Gërguri; Redaktor: Arben Mustafa; Autorë: Sokol Havolli, Astrit Panxha

Përdoruesit e të dhënave kërkohen të citojnë burimin. Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

Ky publikim përfshinë të dhënat në dispozicion deri më 31 dhjetor 2012.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE-----i

Zhvillimet në tregjet globale----- 03

Ekonomia e Kosovës ----- 05

| | |
|-------------------------------------|----|
| Sektori Real ----- | 05 |
| Sektori Financiar ----- | 06 |
| Kompanitë e Sigurimit ----- | 10 |
| Fondet Pensionale ----- | 10 |
| Institucionet Mikrofinanciare ----- | 10 |
| Tregu i Kapitalit ----- | 10 |
| Sektori i Jashtëm ----- | 11 |

GRAFIKËT DHE TABELAT ----- 03

| | |
|--|----|
| Figura 1. Çmimi i naftës “brent crude” ----- | 03 |
| Figura 2. Çmimi i metaleve ----- | 03 |
| Figura 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit ----- | 04 |
| Figura 4. Norma e këmbimit të euros ----- | 04 |
| Figura 5. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e financimit të ECB-së ----- | 04 |
| Figura 6. Rritja reale e PBB-së ----- | 05 |
| Figura 7. Indeksi i Çmimeve të Konsumit ----- | 05 |
| Figura 8. Regjistri i bizneseve ----- | 06 |
| Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja ----- | 06 |
| Figura 10. Trendi i rritjes së depozitave dhe kredive ----- | 07 |
| Figura 11. Vlera e kredive sipas veprimtarisë ekonomike ----- | 07 |
| Figura 12. Mesatarja vjetore e normave të interesit ----- | 08 |
| Figura 13. Normat mesatare të interesit për kredi për ndërmarrje ----- | 08 |
| Figura 14. Treguesit e profitabilitetit ----- | 09 |
| Figura 15. Raporti NPL/gjithsej kreditë ----- | 09 |
| Figura 16. Ankandet në letra me vlerë të Qeverisë ----- | 10 |
| Figura 17. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar ----- | 11 |
| Figura 18. Pranimet e dërgesave të emigrantëve ----- | 12 |
| Figura 19. Investimet e huaja direkte sipas investimit ekonomik ----- | 12 |
| Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik ----- | 14 |

SHKURTESAT:


| | |
|------|---|
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BQK | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës |
| CAR | Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>) |
| CHF | Franku Zvicerran (<i>angl. Swich Franc: CHF</i>) |
| CPI | Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>) |
| ECB | Banka Qendrore Evropiane (<i>angl. European Central Bank: ECB</i>) |
| EJL | Evropa Juglindore |
| EUR | Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>) |
| GBP | Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>) |
| IHD | Investimet e Huaja Direkte |
| IMF | Fondi Monetar Ndërkombëtar (<i>angl. International Monetary Fund: IMF</i>) |
| NPL | Kreditë Jopërfomuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>) |
| PBB | Produkti i Brendshëm Bruto |
| ROAA | Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>) |
| ROAE | Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>) |
| RWA | Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>) |
| SHBA | Shtetet e Bashkuara të Amerikës |
| USD | Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>) |

Zhvillimet në Tregjet Globale

Rritja reale ekonomike në nivel global gjatë vitit 2012 arriti normëm prej 3.2 përqind. Norma më e ulët e rritjes gjatë vitit 2012 u shënuar në TM4 kur ekonomia globale u rritë me 2.9 përqind. Bartës të rritjes ekonomike gjatë vitit 2012 ishin vendet në zhvillim dhe SHBA-të. Rritja ekonomike në vendet e eurozonës është paraparë të jetë negative për 0.7 përqind gjatë vitit 2012, që paraqet vazhdimësi të rritjes negative në çdo tremujor që nga TM4 i vitit 2011. Recesioni në eurozonë vazhdon të shkaktohet nga rënia e kërkesës së brendshme si rezultat i politikave fiskale të shtrënguara të cilat kanë qëllim të zvogëlojnë borxhin publik. Zhvillimet në eurozonë në masë të madhe janë reflektuar edhe në Evropën Juglindore (EJL), duke ndikuar që norma e rritjes të jetë më e ulët por se aktiviteti ekonomik vazhdoi të jetë pozitiv në TM4 2011 (IMF, WOE 2013).

Çmimet e naftës (brent crude)¹ në nivel global shënuan rritje më graduale krahasuar me periudhën 2007-2008. Rritja vjetore e çmimeve të naftës në TM4 2012 ishte 4.5 përqind, ndërsa krahasuar me TM3 2012 çmimet e naftës shënuan rritje prej 1.1 përqind. Në vitet e fundit, përkundër ngadalësimit ekonomik që në shumë raste ndikon që çmimi i naftës të bie substancialisht, zhvillimet politike në lindjen e mesme, si në Egjipt, Libi dhe Siri, kanë ndikuar që çmimi i naftës të mbetet në nivele të larta si rezultat i pasigurive nga ndonjë goditje substanciale në anën e ofertës (Figura 1).


Figura 1. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: Bloomberg (2013)

Çmimet e Metaleve gjatë vitit 2012 u karakterizuan me stabilitet që në masë të madhe reflekton zhvillimin më të ngadalshëm ekonomik gjatë këtij viti (Figura 2). Stabilizimi i çmimeve të metaleve pritet të ketë efekte pozitive në qëndrueshmërinë e eksporteve të Kosovës marrë parasysh se metalet dominojnë në strukturën e eksporteve të Kosovës.

Figura 2. Çmimet e metaleve, në USD




Burimi: Bloomberg (2013)

Produktet ushqimore në tregjet globale u karakterizuan me rritje relativisht të lartë gjatë TM4 2012 krahasuar me TM4 2011. Rritja e çmimeve gjatë kësaj periudhe për burim ka prodhimin më të dobët se

¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikimin tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global


sa pritjet në nivel global, që në masën më të madhe u ndikua nga kushtet negative klimatike (Figura 3).

Figura 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Norma e këmbimit ndërmjet euros (EUR) dhe valutave kryesore botërore u karakterizua me stabilitet (Figura 4). Euro (EUR) kundrejt dollarit amerikan (USD) gjatë vitit 2012 u zhvlerësua në çdo tremujor, por se norma e zhvlerësimit u zvogëlua gjatë TM4 2012.

Figura 4. Norma e këmbimit e Euros




Burimi: Bloomberg (2013)

Valuta EUR kundrejt Frankut Zviceran (CHF) gjatë vitit 2012 u karakterizua me stabilitet, ndërsa në TM4 2012 krahasuar me TM4 2011 EUR u devalvua për 1.8 përqind. EUR humbi vlerë gjithashtu kundrejt

Sterlinës Britanike (GBP) për 5.8 përqind në TM4 2012 krahasuar me TM4 2011. Sidoqoftë, vlenë të theksohet se gjatë gjithë vitit 2012, ishte pikërisht TM4 ai i cili regjistroi përmirësim në raportin EUR/GDP. Kjo pasi që gjatë pjesës së dytë të vitit 2012 u regjistruan përmirësime në aspektin fiskal si dhe rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve në vendet kryesore të eurozonës.

Euribor që paraqet normën e interesit për kreditim ndërbankar në eurozonë gjatë vitit 2012 shënoi rënie, ndërsa, nivelin më të ulët e arriti në TM4 2012. Faktori kryesor në rënien e Euribor-it është norma bazë e financimit e Bankës Qendrore Evropiane (*angl. European Central Bank: ECB*) e cilan në korrik të vitit 2012 zbriti në 0.75 përqind nga 1 përqind sa ishte në gjysmën e parë të vitit 2012 (Figura 5).

Figura 5. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së




Burimi: Euribor (2013) dhe ECB (2013)

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Rritja reale e PBB-së në vitin 2012 arriti normën prej 3.8 përqind, ndërsa bartës kryesor i rritjes ishte sektori publik nëpërmjet investimeve kapitale.

Figura 6. Rritja Reale e PBB-së, në përqindje




Burimi: ASK (2013), (f)IMF WOE (2013)

Sektori privat kontribuoi në rritjen ekonomike nëpërmjet rritjes së konsumit, ndërsa investimet private u karakterizuan me zhvillime të ngjashme me vitin paraprak, pozitive por me trend të ngadalsuar. Me gjithë rritjen e konsumit privat, ndikimi i këtij sektori në rritjen ekonomike ishte më i ulët se sa në vitet paraprake. Rritja gjatë vitit 2012 në masë të konsiderueshme është limituar nga pozicioni i Kosovës në sektorin e jashtëm sidomos në kuadër të eksporteve dhe investimeve të huaja direkte, ndërsa, dërgesat e emigrantëve u karakterizuan me normë pozitive të rritjes edhe në TM4 2012.

Ecuria e çmimeve, e shprehur nëpërmjet indeksit të çmimit të konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*) gjatë TM4 2012 u karakterizua me inflacion të moderuar marrë parasysh se rritja vjetore e çmimeve

arriti në 3.7 përqind, ndërsa norma mesatarja vjetore e inflacionit për vitin 2012 arriti në 2.5 përqind.

Figura 7. Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor



Burimi: ASK (2013)


Ashtu si edhe në vitet paraprake, ishin çmimet e produkteve të importuara ato që kishin ndikimin kryesor në normën e inflacionit në Kosovë. Deri në shtator 2012, çmimet e importit shënuan rritje prej 5.8 përqind krahasuar me shtator 2011, ndërsa çmimet e prodhimit ishin më stabile duke shënuar një normë mesatare të rritjes prej 0.8 përqind.

Inkurajues për aktivitetin ekonomik në vend është ndryshimi i peshave dhe pjesëmarrjes në shportën e konsumatorit të disa kategorive si p.sh. produktet ushqimore që kishin pjesëmarrje mjaft të lartë. Në vitin 2012 pesha e produkteve ushqimore shënoi rënie në 37.8 përqind të gjithsej shportës së konsumatorit krahasuar me vitin paraprak kur pesha e kësaj kategorie ishte në 42.7 përqind. Ky ndryshim reflekton përmirësimin e standardit jetësor në Kosovë marrë parasysh konsumin më të lartë të kategorive tjera jo-ushqimore.² Ky ndryshim në strukturë gjithashtu mund të konsiderohet si zhvillim pozitiv

² Rritje e pjesëmarrjes në shportën e konsumatorit është vërejtur në kategoritë orënditë shtëpiake dhe pajisje për mirëmbajtje, transporti, mjetet e komunikimit, rekreacion dhe kulture si dhe restorantet dhe hotelet.

për sa i përket stabilitetit të përgjithshëm të çmimeve në të ardhmen, marrë parasysh se çmimet e produkteve ushqimore janë karakterizuar me lëvizjet më të mëdha, përdërisa pesha e lartë e tyre ka reflektuar mjaft shumë në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në Kosovë.

Figura 8. Regjistri i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2013)

Gjatë vitit 2012, numri i bizneseve të reja të regjistruara është rritur për mbi 20 përqind duke arritur në 2261 biznese të reja, që paraqet numrin më të madh të bizneseve të reja të regjistruara në katër vitet e fundit. Edhe mbyllja e bizneseve gjithashtu kishte normë relativisht të lartë të rritjes (16.7 përqind) në krahasim me vitin e kaluar me një numër prej 334 biznese të mbyllura. Raporti ndërmjet bizneseve të mbyllura dhe atyre të reja gjatë vitit 2012 ishte 11.2 përqind, që paraqet normën më të ulët në katër vitet e fundit.

Bazuar në aktivitetin ekonomik që ndërmarrjet e kanë regjistruar, vërehet se kategoria dominuese vazhdon të jetë tregtia e cila ka një pjesëmarrje në ndërmarrjet e reja prej 31.3 përqind, përkundër zvogëlimit të pjesëmarrjes në krahasim me periudhat tjera.

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2013)

Kjo vjen si rezultat i përshpejtimit të normës së rritjes për ndërmarrjet e sektorëve tjerë, sidomos rritja më e theksuar e ndërmarrjeve në sektorin e bujqësisë që arriti në 8.3 përqind nga 4.1 përqind sa ishte në vitin paraprak, pastaj industria perpunuese në 10.3 si dhe ndërtimtaria në 9.7 përqind. Ndërmarrjet e regjistruara për aktivitet me patundshmëri, transport dhe telekomunikacion dhe magazinim si dhe hoteleria dhe restorantet kishin një pjesëmarrje relativisht të ngjashme me vitet paraprake.


Implikimet e përgjithshme të këtij ndryshimi në strukturën e ndërmarrjeve pritet të jenë pozitive për aktivitetin ekonomik në vend, sidomos kur merret parasysh aftësia për të shtuar vlerë nga ndërmarrjet e këtyre sektorëve.

Sektori Financiar

Ngadalësimi i përgjithshëm i aktivitetit në ekonominë e Kosovës u reflektua edhe në sektorin financiar. Në TM4 të vitit 2012 sektori financiar i Kosovës shënoi rezultate më të dobëta krahasuar me vitin paraprak. Në fund të vitit 2012, asetet e sistemit bankar arritën në 2.8 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 6.8 përqind që paraqet rritje më të ulët krahasuar me

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur u regjistrua rritje prej 7.9 përqind.

Figura 10. Trendi i rritjes së depozitave dhe kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Me qëllim të përmirësimit të performancës si dhe menaxhimit të rrezikut në periudha afatgjate disa nga bankat u fokusuan në zvogëlimin e gjithsej asetëve. Edhe pse norma e rritjes së depozitave ishte më lartë se norma e rritjes së kredive, bankat u treguan më të kujdesshme në kreditimin e ekonomisë (Figura 10). Në TM4 depozitat e sistemit bankar arritën në 2.27 miliardë euro duke shënuar rritje prej 3.8 përqind krahasuar me TM3. Kreditë regjistruan rritje prej 0.2 përqind duke arrit në 1.76 miliardë euro që paraqet një rritje të lehtë krahasuar me TM3 kur rritja ishte negative.


Gjatë gjithë vitit 2012, bankat ishin më të orientuara në kreditimin e ekonomive familjare krahasuar me kreditimin e ndërmarrjeve, ku mund të vërehet se kreditimi për ndërmarrjet shënoi rritje vjetore prej vetëm 3 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 6.2 që e regjistroi sektori i ekonomive familjare.

Statistikat e raportuara nga bankat mbështeten edhe në rezultat e anketës së realizuar nga BQK-ja me bankat të cilat operojnë në Kosovë. Bazuar në

rezultatet e anketës, gjatë gjithë vitit 2012, del se bankat raportuan ulje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, ndërsa rritje të kërkesës nga ekonomitë familjare. Po ashtu, bankat raportuan shtrëngim të standardeve dhe kritereve të aplikuara në procesin e kreditimit për të dyja kategoritë. Sipas bankave, faktorët kryesor që ndikuan në këtë shtrëngim ishin perceptimi negativ nga ana e bankave për gjendjen e përgjithshme ekonomike.

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomikë gjatë TM4 nuk regjistroi ndonjë ndryshim të theksuar (Figura 11).

Figura 11. Vlera e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


Kreditë e destinuar për tregti vazhdojnë të dominojnë dhe të jenë një prej kategorive me rritjen më të lartë. Në fund të vitit 2012, kreditë për sektorin e tregtisë arritën vlerën prej 635.3 milionë krahasuar me 606.2 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa, sektori i bujqësisë edhe pse ka një pjesëmarrje pothuajse të barabartë me sektorin e tregtisë në përbërjen PBB-së (në vitin 2011, bujqësia përbënte 14.1 përqind ndërsa tregtia 14.5 përqind të PBB-së), kreditimi i bujqësisë krahasuar me sektorin e tregtisë vazhdon të jetë shumë më i ulët. Sidoqoftë,

numri më i lartë i ndërmarrjeve të reja të regjistruara në sektorin e bujqësisë, si dhe rritja e subvencioneve për bujqësinë nga ana e qeverisë, mund të ndikojë në përmirësimin e perspektivës së këtij sektori, duke bërë që ky sektor të jetë më atraktiv edhe për kreditimin nga sektori bankar.

Lëvizja e normave të interesit u karakterizua me rënie për kreditë, ndërsa normat e interesit në depozita shënuan ngritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 12). Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua nga 14.1 përqind në dhjetor 2011, në 13.4 përqind në dhjetor 2012. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita u ngrit nga 3.5 përqind në 3.6 përqind, gjatë periudhës në fjalë. Si rrjedhojë, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita (*angl. interest rate spread*) u zvogëlua në 9.8 pp, nga 10.6pp sa ishte në dhjetor 2011.

Nëse shikohen normat mesatare të interesit të kredive për ndërmarrjet sipas shfrytëzimit dhe maturitetit, në figurën 13 mund të vërehet se normat mesatare të interesit kanë përcjell një trend rënës për të gjitha kategoritë. Kreditë e ndërmarrjeve të destinuara për investime mesatarisht ishin në nivele më të ulëta krahasuar me normat e interesit për kreditë dhënë ndërmarrjeve për qëllime tjera të shfrytëzimit. Po ashtu, në të dy kategoritë, kreditë me maturitet më të gjatë (mbi 1 vit) kishin normë më të ulët të interesit krahasuar me kreditë më maturitet deri në 1 vit.


Figura 12. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


Performanca e sistemit bankar në Kosovë vazhdon të jetë pozitive, mirëpo vërehet dobësim i indikatorëve të profitabilitetit krahasuar me periudhën paraprake. Në figurën 14 mund të vërehet se Kthimi Mesatar në Asete (ROAA) dhe Kthimi Mesatar në Ekuitet (ROAE) shënuan rënie.

Figura 13. Normat mesatare të interesit për kredi për ndërmarrjet, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


Figura 14. Treguesit e profitabilitetit



Burimi: BQK (2013)

Gjithsej profiti i sistemit bankar për vitin 2012 pothuajse u përgjysmua në 19.2 milionë euro nga 36.6 milionë euro sa ishte në fund të vitit 2011. Nga gjithsej 9 banka sa operojnë në Kosovë, 5 raportuan profit neto pozitiv, ndërsa 4 raportuan profit neto negativ. Ndikim kryesor në uljen e profitit të sistemit bankar kishte përkeqësimi i portfolios kreditore që gjë u reflektua në rritjen e shpenzimeve për mbulimin humbjeve nga kreditë joperformuese me provizione. Për periudhën në fjalë, raporti ndërmjet Kredive Joperformuese (*angl. Non Performing Loans: NPL*) dhe gjithsej kredive arriti në 7.5 përqind nga 7.0 sa ishte në shtator 2012 (Figura 15).

Figura 15. Raporti NPL/ gjithsej kreditë, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Edhe përkundër rritjes së nivelit të kredive joperformuese, bankat vazhdojnë të tregohen konzervative në mirëmbajtjen e mbulimit të NPL-ve me provizione për humbje nga kreditë. Në dhjetor 2012, ky tregues qëndronte në 112.7 përqind.

Sa i përket nivelit të likuiditetit të sistemit bankar, bankat u treguan mjaft të kujdesshme duke e mbajtur shkallën e rezervës në nivel më të lartë se niveli i kërkuar nga Banka Qendrore. Po ashtu, gjendja e kënaqshme e likuiditetit vërtetohet përmes raportit të kredive me depozita prej 77.4 përqind, si dhe asetëve 'broad' likuide në raport me gjithsej asetet prej 32.5 përqind.

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar edhe përkundër rënies së lehtë të Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*)³, i cili u zvogëlua nga 18.8 përqind sa ishte në dhjetor 2011, në 17.9 përqind në dhjetor 2012. Në fund të vitit 2012, gjithsej kapitali i sistemit bankar arriti në 310.9 milionë euro dukë shënuar rritje vjetore prej 3.7 përqind, ndërsa Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (*angl. Risk Weighted Assets: RWA*) u ngritën për 1.7 përqind duke qëndruar në 1.73 miliardë euro.

Gjatë vitit 2012, sistemit bankar të Kosovës iu shtua edhe një bankë. Në muajin nëntor, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës aprovoi licencën për një bankë të re me kapital turk, "Turkie Is Bankasi A.S" gjë që e ngriti numrin e gjithsej bankave në Kosovë në nëntë.

³ Sipas rregullave të BQK-së, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të kapitalit rregullativ në raport me asetet e peshuara ndaj rrezikut.

Kompanitë e Sigurimit

Të dhënat e fundit në dispozicion për kompanitë e sigurimeve sugjerojnë për zgjerim të aktiviteti në këtë sektor. Në fund të vitit 2012, vlera primeve të pranuar arriti në 81.5 milionë euro duke regjistruar rritje vjetore prej 4.4 përqind. Ndërsa, gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, dëmet e paguara arritën në 30.6 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 25.1 përqind.

Fondet pensionale

Gjatë vitit 2012, Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK-së) regjistroi një performancë pozitive, krahasuar me vitin paraprak. Vlera e përgjithshme e aseteve në menaxhim të fondit arriti në 739.8 milionë euro (dhjetor 2011, 593.3 milionë euro) ndërsa çmimi i aksioneve ishte 1.117 euro për aksion (dhjetor 2011, 1.034 euro për aksion). Kthimi i përgjithshëm në investimet e bëra për vitin 2012 ishte 8 përqind ose 54.2 milionë euro.


Institucionet mikrofinanciare

Gjatë vitit 2012, performanca e IMF-ve shënoi rënie në të gjithë treguesit e raportuar. Gjithsej kreditë e lëshuara nga IMF-t pësuan rënie të vazhdueshme gjatë vitit 2012, ku në dhjetor arritën në 98.8 milionë euro nga 104.7 milionë sa ishin në dhjetor 2011 (rënie vjetore prej 5.6 përqind). Përkundër normave të larta të kamatave (norma mesatare prej 22.48 përqind në dhjetor 2012) gjatë periudhës në fjalë, IMF-t regjistruan humbje në vlerë prej 4.5 milionë euro (në vitin 2011 u regjistrua profit në vlerë prej rreth 0.9 milionë euro).

Tregu i Kapitalit

Tregu i bonove të thesarit të Qeverisë së Kosovës që filloi në janar të vitit 2012 paraqet komponentën e vetme në kuadër të tregut të kapitalit në Kosovë. Gjatë TM4 2012 u mbajtën 3 ankande, të cilat kishin shumë të ofruar prej 10 milionë eurove me afat maturimi prej 91 ditë (Figura 16). Nga këto shuma, 10 përqind e gjithsej ofertave ishin jo konkurruese, ndërsa pjesa tjetër ishin konkurruese. Ofertimi nga akterët primar në çdo rund tejkaloi shumën e ofruar nga Thesari mesatarisht për 2.1 herë gjatë TM4 2012.

Figura 16. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë, në milionë euro



Vërejtje: Ankandet janë për shumatat e ofertuara për 91 ditë.
 (a) ankande për 192 ditë
 Burimi: BQK (2012)

Norma e interesit në ankandet e deritanishme është karakterizuar me rënie të vazhdueshme duke arritur në nivelin 1.08 përqind në dhjetor, niveli më i ulët gjatë gjithë vitit. Tejkalimi i ofertës së Thesarit nga ofertimet e akterëve primarë për 2.1 herë, si dhe në anën tjetër rënia e vazhdueshme e normës së interesit në çdo ankand mund të konsiderohet si reflektim me rëndësi mbi gjendjen në sektorin financiar, fiskal dhe real të ekonomisë.

Nga pikëpamja e sektorit financiar, ofertimi i lartë reflekton likuiditetin e kënaqshëm në sistemin bankar si dhe prirjen e bankave që të shfrytëzojnë mjetet e lira duke diversifikuar njëkohësisht më mirë portfolion e investimeve të tyre.


Në kontekst të sektorit fiskal, rënia e vazhdueshme e normës së interesit reflekton besimin e institucioneve financiare në stabilitetin fiskal të qeverisë së vendit.

Në sektorin real, ofertimi i bankave me normë të ulët të interesit reflekton mungesën e kapaciteteve absorbuese dhe projekteve investive të sektorit privat të ekonomisë. Kjo pasi që bankat vazhdojnë të kenë kapacitete për të investuar në bono të thesarit me normë relativisht të ulët të interesit kundrejt kreditimit të ekonomisë e cila karakterizohet me normë relativisht të lartë të interesit. Përveç normës së interesit, blerja e bonove të thesarit gjithashtu tregon për qasjen e kujdesshme ndaj rrezikut nga bankat komerciale në vend duke investuar në instrumente pa rrezik.

Sektori i Jashtëm

Statistikat e tregtisë që nga shtatori 2012 kanë pësuar ndryshim metodologjik si rezultat i mospërfshirjes së statistikave për tregtinë e energjisë elektrike në gjithsej aktivitetin tregtar. Sidoqoftë, me të dhënat në dispozicion, deficiti i llogarisë rrjedhëse në TM4 2012 arriti në 574.1 milionë euro si rezultat i importeve në vlerë prej 641.2 dhe eksporteve prej 67.1 milionë euro. Sidoqoftë, përkundër mospërfshirjes së statistikave të tregtisë së energjisë, bilanci i llogarisë rrjedhëse gjatë TM4 2012 shënoi rënie për rreth 10 përqind, që njëherësh paraqet rënien më të theksuar periudhën e pasluftës.

Figura 17. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative




*Vërejtje: Që nga shtatori 2012, ASK nuk përfshinë energjinë elektrike në llogaritjet për eksport dhe import
Burimi: ASK (2013)

Deri në fund të vitit 2012, eksporti i mallrave arriti në 269.3 milionë euro, ndërsa importi i mallrave arriti shumë më prej 2.5 miliardë euro, duke bërë që mbulueshmëria e importeve me eksporte të arrijë normën prej 10.8 përqind.


Dërgesat e emigrantëve si njëra ndër komponentat më të rëndësishme në bilancin e pagesave të Kosovës deri në shtator 2012 arritën shumë më e 436.7 milionë euro që krahasuar me shtatorin 2011 paraqet një rritje prej 2.0 përqind. Rritja e dërgesave të emigrantëve në Kosovë konsiderohet të ketë pasur në vazhdimësi një sjellje kundërciklike kur merret parasysh se kanë sjellje të kundërt me indikatorët tjerë makroekonomik shumica nga të cilët gjatë kësaj periudhe u karakterizuan me zhvillime më të ngadalshme ose negative.

Figura 18. Pranimet e dërgesave të emigrantëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Figura 19. Investimet e Huaja Direkte spas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK (2013)

Komponentë tjetër me rëndësi të madhe në kuadër të bilancit të pagesave janë edhe Investimet e huaja direkte (IHD) të cilat deri në shtator 2012 arritën vlerën prej 167.0 milionë euro. Sidoqoftë, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, IHD-të kanë shënuar rënie substanciale prej 41.3 përqind. Rënia e IHD-ve përveç përkeqësimit të ambientit të përgjithshëm ekonomik në Evropë, në masën më të madhe i adresohet ngadalsimit të procesit të privatizimit gjatë vitit 2012. Rifillimi i procesit të privatizimit do të pritët të reflektojë në rritje të IHD-ve, ndërsa edhe pritjet për rikuperim ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2013 pritët të reflektojnë pozitivisht në nivelin e IHD-ve.

Përveç efektit të rënies i cili ndikon në gjenerimin e punësimit në vend, për vitin 2012, ndryshimi i strukturës së IHD-ve nuk është në favor të rritjes së punësimit marrë parasysh se sektorët që më së shumti gjenerojnë IHD janë sektorë që nuk kanë hapësirë të madhe në krijimin e punësimit. Kjo pasi që patundshmëria ka dyfishuar pjesmarrjen në IHD, ndërsa kryesisht përbëhet nga blerja e patundshmërisë nga jo-rezidentët në Kosovë.

Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:

BQK (2013): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 1 TM4, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2013):

- a) Buletini Mujoor Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,129>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>
- d) Raporti i Stabilitetit Financiar nr 3. <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,131>
- e) Raporti i Bilancit të Pagesave; <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,133>

ASK (2013):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në shkurt 2013: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në shkurt 2013:
http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në shkurt 2013:
http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në shkurt 2013:
<http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtise së jashtme, qasur në shkurt 2013:
<http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2013): Metal Prices database, qasur në shkurt 2013

FAOUN (2013): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: qasur në shkurt 2013: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/wfs-home/foodpricesindex/en/>

Euribor (2013): Euribor Historical Rates, qasur në shkurt 2013:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2013): World Economic Outlook: qasur në shkurt 2013

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2012/01/weodata/weoselgr.aspx>

Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik

| Përshkrimi | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| Sektori real 1/ | | | | | | | |
| PBB (në milionë euro) | 3,105.1 | 3,379.4 | 3,710.7 | 4,077.0 | 4,136.5 | 4,486.0 | - |
| Çmimet (mesatarja vjetore) | 0.6% | 4.4% | 9.4% | -2.4% | 3.5% | 7.3% | 2.5% |
| Çmimet (ndryshimi vjetor) | 1.1% | 10.5% | 0.5% | 0.1% | 6.6% | 3.6% | 3.7% |
| Sektori fiskal 2/ | | | | | | | |
| Të hyrat (në milionë euro) | 713.0 | 903.0 | 943.0 | 1,147.0 | 1,179.0 | 1,303.3 | - |
| Shpenzimet (në milionë euro) | 636.0 | 662.0 | 951.0 | 1,233.0 | 1,272.0 | 1,388.0 | - |
| Bilanci, si përqindje e PBB-së | 2.5 | 7.1 | (0.2) | (2.1) | (2.2) | (1.9) | - |
| Sektori financiar (në milionë euro) 3/ | | | | | | | |
| Asetet e korporatave financiare | 2,159.0 | 2,941.9 | 3,370.3 | 4,005.0 | 4,440.5 | 4,732.0 | 5,289.3 |
| prej të cilave: Bankat | 1,161.2 | 1,435.0 | 1,808.2 | 2,204.1 | 2,455.0 | 2,648.2 | 2,830.4 |
| Kredi | 636.6 | 892.1 | 1,183.4 | 1,289.0 | 1,458.7 | 1,683.1 | 1,763.4 |
| Depozita | 924.3 | 1,143.1 | 1,444.1 | 1,744.9 | 1,936.9 | 2,113.5 | 2,279.0 |
| Norma e interesit në kredi | 14.7 | 14.6 | 14.7 | 14.3 | 14.6 | 14.1 | 13.4 |
| Norma e interesit në depozita | 3.0 | 3.3 | 4.2 | 4.3 | 3.7 | 3.5 | 3.6 |
| Hendeku i normës së interesit | 11.8 | 11.3 | 10.5 | 10.0 | 10.9 | 10.6 | 9.8 |
| Sektori i jashtëm (në milionë euro) 3/ | | | | | | | |
| Bilanci i pagesave | | | | | | | |
| Llogaria rrjedhëse | -226.1 | -354.1 | -628.7 | -412.1 | -558.6 | -673.6 | -423.0 |
| prej të cilave: importi i mallrave | -1,295.6 | -1,545.2 | -1,885.7 | -1,828.9 | -2,057.1 | -2,383.9 | -1,548.9 |
| prej të cilave: dërgesat e emigrantëve | 467.1 | 515.6 | 535.4 | 585.7 | 584.3 | 584.8 | 436.7 |
| Llogaria financiare | -35.7 | -5.8 | 288.5 | 113.1 | 275.9 | 377.5 | 63.6 |
| Investimet e huaj direkte në Kosovë | 294.8 | 440.7 | 366.5 | 291.4 | 365.8 | 393.9 | 178.4 |
| Investimet portfolio, net | -65.4 | -34.5 | -109.9 | -124.4 | -49.2 | -57.0 | -207.0 |
| Investimet tjera, net | -181.6 | -108.0 | 75.2 | -138.3 | 47.4 | -5.7 | 334.6 |
| Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net | n/a | 1,278.9 | 941.2 | 524.4 | 444.6 | 104.5 | 319.9 |
| Asetet | n/a | 2,397.6 | 2,536.0 | 2,812.1 | 3,249.4 | 3,328.4 | 3,634.0 |
| Detyrimet | n/a | 1,118.6 | 1,594.9 | 2,287.8 | 2,804.8 | 3,223.8 | 3,314.1 |
| Borgji i jashtëm, gjithsej | n/a | 496.3 | 706.8 | 1,146.4 | 1,348.3 | 1,426.8 | 1,536.9 |
| Borxhii i jashtëm privat | n/a | 496.3 | 706.8 | 837.1 | 1,022.4 | 1,106.7 | 1,175.8 |
| Borxhii i jashtëm publik | n/a | n/a | n/a | 309.3 | 325.9 | 320.0 | 361.2 |

Burimi:

1/ ASK (2013)

2/ MF (2013)

3/ BQK (2013)

